

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/32700-26-5646-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Motoçikleta për Ekipet e Kërkim Shpëtimit dhe NJPZSH-të**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

L Moto SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Magjistralka Prishtin-Shkup, km 10

(Adresa)

Prishtin - Kosove

(Vendi)

+386 (0) 49 282 289

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

Shpend Zenuni

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

contact@l-moto.com

(Adresa elektronike)

31.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftim per Kontrat wshtw publikuar me datë 20/07/2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me datë 28/08/2026

Kerkesa për Sqarime shtese te datës 06/08/2026

Përgjigjet me datës 10/08/2026

Kërkesa për rishqyrtim me datë 20.08.2026

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me datë 21.08.2026

Formulari per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara me datë 24.08.2026

Shtyrja e Afati për dorëzimin e ofertave me datë 03/09/2026

Ankesa parashtrohet brenda afatit kohor të paraparë me LPP-së.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo



Ankesa dorëzohet para hapjes së ofertave

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 19 i Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Për aktivitetin e Prokurimit me titull "Furnizim me Motoçikleta për Ekipet e Kërkim Shpëtimit dhe NJPZSH-të " me numër të prokurimit 214/32700-26-5646-1-1-1, pas shqyrtimit dhe analizimit në detaje të specifikimeve teknike të detyrueshme në Aneksin 1 të dosjes së tenderit për Motoçikleta. Edhe pse kemi kërkuar sqarime për specifikacionet teknike dhe nuk përgjigjet e

pranuara nga AK duke mos i aprovuar terwwsisht modifikimin e specifikacioneve teknike ne paraqesim Kerkesen për Rishqyrtim pasi konsiderojmë dhe janw vertetuar se specifikimet teknike të përcaktuara per Motoçikleta dhe për bateri janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik si dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024.

Nga analiza e specifikimeve teknike për motoçikletë rezulton se specifikacionet e kerkuara janë tepër specifike dhe janë të përshtatura vetëm një prodhuesi ku te gjitha keto specifika i referohen modelit/prodhuesin LONCIN WXOLF 1000 L V-Twin EPS (si diler i autorizuar është kompania FAZE MOTORS), ku kufizojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Në veçanti, kufizimi i konkurrencës rezulton nga kombinimi i kërkesave si në vijim:

Furnizim me Motoçikleta për Ekipet e Kërkim Shpëtimit dhe NJPZSH-të	
Specifikimi i kërkuar në tender	Specifikimi i mjetit të ofruar
Cilindrat - (jo me pak se 970cc)	962.5cc
Çifti rrotullues - (jo me pak se 93 Nm)	88 Nm
ABS - (Preferohet sistemi ABS me shum kanale ose akuvalent,nese ofrohet nga konfigurimi)	Nuk ka ABS
Gjatesia - (rreth 2330 mm)	2445 mm
Gjersia - (rreth 1270 mm)	1282 mm
Lartesia - (rreth 1400 mm)	1465 mm
Madhesia - (Preferohet ekran 5" deri 7")	8"
Te gjitha keto specifika I referohen modelit:	LONCIN WXOLF 1000 L V-Twin EPS)

Te gjatësia, gjersia dhe lartësia Ju nuk keni lënë hapësir pasi që këni përdore fjalën “ rreth” që nënkupton dimension të sakt dhe duke mos kerkuar minimum në mënyrë që të përfshihen edhe prodhues dhe brende tjera dhe të lejohet nje konkurrence e hapur duke shkelur nenit 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafi 1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente; paragrafi 2 — Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3.Shkelja e nenit 7, paragrafi 3 — Ndalimi i specifikimeve që favorizojnë ose diskriminojnë

Neni 7 paragrafi 3 ndalon që, gjatë përcaktimit të nevojave, specifikimit të lëndës së prokurimit ose vendosjes së kërkesave dhe specifikimeve teknike, të favorizohet ose diskriminohet një ose më shumë operatorë ekonomikë.

Edhe pse në dosjen e tenderit nuk përmendet emri i një marke/modeli, mirëpo specifikacionet teknike përputhet me karakteristikat e modelit/prodhuesin LONCIN WXOLF 1000 L V-Twin EPS, duke krijuar dyshimin e bazuar se specifikimet janë hartuar në funksion të një produkti të caktuar.

4. Shkelja e nenit 7, paragrafi 6 obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë clhe të eliminojë praktikat, kriteret, kërkesat (specifikimet teknike që diskriminojnë në favor ose kundër operatorëve ekonomikë, Specifikimet teknike e kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë duke kufizuar produktet që mund të ofertohe

5, Shkelja e nenit 28, paragrafi 2 — Specifikimet teknike

Neni 28 paragrafi 2 përcakton se specifikimet teknike cluhet të hartohen në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të sigurojnë qasje sa më të mirë për operatorët ekonomikë, pa favorizuar Ose diskriminuar operatorë të caktuar,
Kombinimi i kërkesave teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit kufizon qasjen e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit

6. Shkelja e Neni 28 paragrafi 3 përcakton se specifikimet teknike mund të formulohen nëpërmjet kërkesave funksionale dhe të performancës.

Specifikimet teknike të motoçikletave janë hartuar duke ju referuar vetëm një brendi sic është sipër përmenduar me lartë me specifikacione teknike të një prodhuesi.

7. Shkelja e neni 28, paragrafi 7 — Ndalimi i referimit në një artikull ose prodhim të veçantë Neni 28 paragrafi 7 ndalon përpilimin e specifikimeve teknike që i referohen një prodhuesi/modeli të veçantë, një procesi të hollësishëm, një shenje dalluese, lloji, origjine të veçantë Ose një prodhimi të caktuar, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

Megjithatë në dosjen e tenderit nuk është përmendur emri i një marke ose modeli, hartimi i specifikacioneve teknike teknike përputhen me karakteristikat e modelit/prodhuesin LONCIN WXOLF 1000 L V-Twin EPS, duke krijuar dyshimin e bazuar se specifikimet teknike janë hartuar duke ju referuar një produkti të caktuar, në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 të Ligjit nr. 04/L042 për Prokurimin Publik.

Pika 16. Helmetat mbrojtëse keni kerkuar Ngjyra - Preferohet ngjyrë e dukshme për përdorim emergjent duke mos specifikuar se cila ngjyre është e përshtatshme dhe që duhet ofruar.

Pytja - cila ngjyre e dukshme është e preferueshme?

Pika 17. Bateri dore profesionale rimbushese - Specifikacionet teknike të detyrueshme AK ka hartuar specifikacionet teknike të një prodhuesi me Brendin NIGHSTICK ku janë 100% specifikacionet e modelit XPR-5568RX.

Bateri dore profesionale rimbushese	Brendi NIGHSTICK
-------------------------------------	-------------------------

AK ka hartuar specifikacionet teknike në kundërshtim me nenin 7 dhe në kundërshtim me nenin 28 Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024.

Për Bateri dore profesionale rimbushese AK është dashtë bëje në Pjesë/Lot baterin pasi që përdorimi i bateris në krahasim me motoçikleta nuk përkojnë njera me tjetren dhe është kufizuese pasi që ka Operator Ekonomik që merren vetëm me shitjen dhe mirëmbajtjen me motoçikleta dhe EO që merren vetëm me Bateri pajisje tjera. Pavarsisht nga kjo AK për bateri i është referuar vetëm një prodhuesi ashtu siç e përmendim me lart prodhuesi me Brendin NIGHSTICK ku janë 100% specifikacionet e modelit XPR-5568RX duke favorizuar një EO të caktuar ashtu siç e ka favorizuar një OE për motoçikleta.

Duke marrë parasysh dispozitat e neni 7 dhe neni 28 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024, konsiderojmë se specifikimet teknike janë formën e publikuar e kufizojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe krijojnë dyshimin e bazuar se janë hartuar duke ju referuar karakteristikave teknike të modelit/prodhuesin LONCIN WXOLF 1000 L V-Twin EPS si dhe për bateri Brendin NIGHSTICK.

Është kërkuar

Servisimi	Te sigurohet servisi i autorizuar ose i kualifikuar
-----------	---

Nuk është specifikuar se servisimi për sa kilometra bëhet apo me mirë sa servise duhet të përfshihen pasi që prodhuesit e ndryshëm kanë rregulla të ndryshme sa i përketë servimit.

Për këto arsye, kërkojmë që të anulohet aktiviteti i prokurimit duke hartuar specifikacione teknike që lehtë hapësirë në dimensionet me minimum (jo rreth) dhe të bëhet ndarja në Pjesë/Lot në mënyrë që të hapet konkurrenca pasi që janë dy artikuj që kanë funksione të ndryshme njëri me tjetrin.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i neni 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët

ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur. Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”. Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe se me këto specifikacione teknike kufizohet konkurrenca dhe dihet fituesi i këtij aktiviteti ashtu siç e kemi përshkruar më lartë per prodhuesin qe janw pwrshatur specifikacionet teknike.

Duke u bazuar në të gjitha specifikacionet teknike te hartuara qe janë diskriminuese-favorizuese dhe në ato specifika të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj specifikat teknike të cilat i kontestuar më lartë duhet ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara. Specifikat teknike që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIMI TË APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE L Moto SH.P.K.

TË NDRYSHOHEN specifikacionet teknike, siç janë përshkruar më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale nuk i kemi llogaritur në këtë fazë mirëpo Mos ndryshimi i specifikacioneve teknike do të cenonte reputacionin e kompanisë sonë, si distributor i prodhuesit të Motoçikletave.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.